



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 33 prot.

Kamëz, më 11.3.2022

V E N D I M

Nr. 29 Datë 11 / 3 2022

MBI

“ NIVELIN E PAGESËS SË QIRASË SIPAS VLERËS SË TREGUT PËR FAMILJET
QË JANË DËMTUAR NGA TËRMETI I DATËS 26.11.2019 ”

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot më 11.03.2022 në kushte të veçanta si pasojë e masave të ndërmarra për parandalimin e përhapjes së virusit COVID-19 , pasi mori në shqyrtim **Projekt-Vendim Nr.26 Datë 9.03.2022** në mbështetje të nenit 8, nenit 2, nenit 29, nenit 54, neni 55, i Ligjit nr.139/2015 “ Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, të Ligjit nr.22/2018 “ Për Strehimin Social ”,

Aktit Normativ Nr.8, datë 07.12.2019, të Këshillit të Ministrave ‘’ Për përdorimin e procedurës së përshpejtuar për subvencionin e pagesës së qirasë së banesës për familjet e mbetura të pastreha, si pasojë e fatkeqesisë natyrore, tërmetit të datës 26.11.2019 ‘’ i ndryshuar me Aktin Normativ Nr.37, datë 24.12.2020, neni 7, LigjitNr.45/2019 “ Për Mbrotjen Civile” si dhe relacionit të Drejtorisë së Emergjencave Civile dhe Strehimit; **Këshilli Bashkiak Kamëz’’;**

V E N D O S I:

1. Nivelin e qirasë mesatare mujore në treg të lirë sipas strukturave të apartamenteve në territorin e Bashkisë Kamëz, si më poshtë:

Nr.	Emërtimi	Njësia	Nr.Frymësh	Sasia	Çmimi mesatar (lekë pa tvsh)
1	Banesa me qira (Apartament tip garsonierë)	muaj	1-2	1	13.000
2	Banesa me qira (Apartament 1 + 1)	muaj	3-4	1	18.000
3	Banesa me qira (Apartament 2 + 1)	muaj	5	1	21.000



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

4	Banesa me qira (Apartament 3 + 1)	muaj	6-8	1	24.000
---	-----------------------------------	------	-----	---	--------

2. Vlera maksimale e subvencionit të qirasë është e barasvlefshme me qiratë mesatare në tregun e lirë sipas vlerave të paraqitura në këtë vendim.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit ligjor nga **Prefekti i Qarkut Tiranë**.

Kryetar Këshilli
Hysen Koldashi

